Fillimi • Kronikë

Ndjekje si në filma/ Policia parandalon vjedhjen me armë në banesën e biznesmenit në Lushnje, 3 autorët largohen me shpejtësi, mjeti del nga rruga dhe...

15 Mars, 2023 10:49

Madhësia e tekstit:

Policia e Lushnjes ka arritur të parandalojë një grabitje me armë që dyshohet se do të bëhej në banesën e një biznesmeni në Lushnje.

Si rezultat janë identifikuar dhe shpallur në kërkim tre autorët, Renato Çala, Florenc Tatoshi dhe Bukurosh Mukja.

Në vendin e quajtur "Rotondo e Çermës", punonjësit e Policisë kanë lokalizuar automjetin e dyshuar dhe i kanë bërë shenjë për të ndaluar, por drejtuesi i automjetit nuk i është bindur urdhrit të punonjësve të Policisë për të ndaluar dhe ka shtuar shpejtësinë duke rrezikuar jetën e punonjësve të Policisë që ishin në rrugë, për të ndaluar këtë automjet.

Shërbimet e Policisë janë vënë menjëherë në ndjekje të automjetit tip "Benz" i cili po lëvizte me shumë shpejtësi në drejtim të Fshatrave të Peqinit. Për shkak të shpejtësisë së madhe, automjeti ka dalë nga rruga dhe tre shtetasit që udhëtonin në automjet e kanë braktisur atë dhe kanë mundur të largohen, duke përfituar nga errësira.

Gjatë kontrollit të automjetit, shërbimet e Policisë gjetën dhe sekuestruan një sasi municioni luftarak.

Njoftimi i policisë:

Lushnjë/Parandalohet një vjedhje me armë.

Kishin planifikuar vjedhje me armë, në rrethin e Lushnjës, falë inteligjencës informative, shërbimet e Policisë parandalojnë vjedhjen.

Gjatë ndjekjes nga Policia, në kuadër të operacionit policor të koduar "Parandalimi", 3 autorët që qarkullonin me një automjet me targa të falsifikuara, duke përfituar nga errësira, braktisën automjetin, por u identifikuan dhe u shpallën në kërkim nga Policia.

Sekuestrohen municion luftarak dhe automjeti i autorëve.

Shërbimet e Komisariatit të Policisë Lushnjë, bazuar në inteligjencën informative se disa shtetas që qarkullonin me një automjet kishin planifikuar të kryenin vjedhje me armë në një banesë, në rrethin e Lushnjës, kanë organizuar punën për parandalimin e vjedhjes, kapjen dhe arrestimin e autorëve.

Në vendin e quajtur "Rotondo e Çermës", punonjësit e Policisë kanë lokalizuar automjetin e dyshuar dhe i kanë bërë shenjë për të ndaluar, por drejtuesi i automjetit nuk i është bindur urdhrit të punonjësve të Policisë për të ndaluar dhe ka shtuar shpejtësinë duke rrezikuar jetën e punonjësve të Policisë që ishin në rrugë, për të ndaluar këtë automjet.

Shërbimet e Policisë janë vënë menjëherë në ndjekje të automjetit tip "Benz" i cili po lëvizte me shumë shpejtësi në drejtim të fshatrave të Peqinit. Për shkak të shpejtësisë së madhe, automjeti ka dalë nga rruga dhe tre shtetasit që udhëtonin në automjet e kanë braktisur atë dhe kanë mundur të largohen, duke përfituar nga errësira.

Gjatë kontrollit të automjetit, shërbimet e Policisë gjetën dhe sekuestruan një sasi municioni luftarak.

Në vijim të veprimeve hetimore, specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Lushnjë, në kuadër të operacionit policor të koduar "Parandalimi", identifikuan tre shtetasit që qarkullonin në automjetin me targa të falsifikuara dhe bënë shpalljen e tyre në kërkim, për veprat penale "Mosbindja ndaj urdhrit të punonjësit të policisë së rendit publik", "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve dhe municionit luftarak" dhe "Falsifikimi i vulave, i stampave ose i formularëve", konkretisht shtetasit: R. Ç., 30 vjeç, F. T., 56 vjeç dhe B. M., 66 vjeç, të tre banues në Elbasan.

Vijon puna për kapjen e 3 shtetasve të shpallur në kërkim, si dhe për dokumentimin e disa vjedhjeve të kryera nga këta shtetas, në rrethin Lushnjë.

Materialet i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, për veprime të mëtejshme.

Për t'u bërë pjesë e grupit '**Balkanweb**' mjafton të klikosh: Join Group dhe kërkesa do t'ju aprovohet menjëherë. Grupi Balkanweb

TË NGJASHME

Tornadoja vdekjeprurëse godet Misisipin, ndi 20 viktima dhe dëme të mëdha në jug të SHBA-së

15 Mars, 2023

VIDEO/ Trajneri De La Fuente debuton me fitore, Spanja thyen pastër Norvegjinë në kualifikuese

15 Mars, 2023

Taboola Feed

Joint pain: A simple trick to relieve pain easily
The Joint Helper · Sponsored

If you own a mouse, you will never turn off your computer again.
No Install. Play for free.
Combat Stage · Sponsored
Play Now

I shiti mbesën si nuse për 6 milijë euro, por u pendua, ekzekutohet 45-vjeçari, familjarët i vënë flakën shtëpisë së autorit: Do u vrasim të gjithëve

I shiti mbesën si nuse për 6 milijë euro, por u pendua, ekzekutohet 45-vjeçari, familjarët i vënë flakën shtëpisë së autorit: Do u vrasim të gjithëve

balkanweb.com

If you have nail fungus, do this immediately
Kelloe · Sponsored
Get Offer

TË FUNDIT NGA -KRONIKË

Qëllohen me armë zjarri në drejtim të një banese në Mamurras, shpallen në kërkim dy autorët. Policia jep detajet

15 Mars, 2023

Ishta nisur drejt Greqisë me mbi 40 mijë euro të padeklaruara, ndalohet në Kakavijë 54-vjeçari, ja ku ia gjetën paratë

15 Mars, 2023

Radhë të gjata në degatë e qytetarëve, pritjet shumë orë, Maqedonisë e Veriut për të bërë pasoret e shtëpisë dhe mbushur makinat me karburant

15 Mars, 2023

EMRU i Lëvizte me automatik, ambulohet 20-vjeçari nga Rashkovec, gjetën 5 mijë me mal municioni luftarak në banesë

15 Mars, 2023

Përplasi me makinë të moshuarën dhe nipin e tij të mitur, arrestohet 32-vjeçari në Tiranë

15 Mars, 2023

EMRU/ Kërkoi ferinë nga arrestia, pas 7 vaxucash Gjykata i refuzon kërkesën biznesmenit të akuzuar për ndërtim të paligjshëm

15 Mars, 2023

KATEGORIA VIDEO

VIDEO/ Trajneri De La Fuente debuton me fitore, Spanja thyen pastër Norvegjinë në kualifikuese

15 Mars, 2023

Zgjedhjet lokale, PS zbulon "akojn" për 14 Majën, ja emrat për 61 bashkitë në vend

15 Mars, 2023

Çfarë do të ndodhë sot në Big Brother Vip Albania? Futet zarfi i kuq në shtëpi

15 Mars, 2023

Zgjedhjet e 14 majit/ "Paratë e bashkatarëve do t'i çojnë tek qytetarët", Balind Kërliu: Transporti publik do të jetë falas

15 Mars, 2023

VIDEO/ Barazim pozitiv në Izrael, Kosova dëshpëron në sfidën e parë kualifikuese, Rashica nuk mjafton

15 Mars, 2023

VIDEO/ Gurrogol në Serbi, Granit Xhaka fantastik me Zvicrën

15 Mars, 2023

Tornadoja vdekjeprurëse godet Misisipin, ndi 20 viktima dhe dëme të mëdha në jug të SHBA-së

15 Mars, 2023

VIDEO/ Trajneri De La Fuente debuton me fitore, Spanja thyen pastër Norvegjinë në kualifikuese

15 Mars, 2023

Lufta në Ukrainë, Maqedonia e Veriut i dhuron Kievit 12 helikopterë luftarakë

15 Mars, 2023

Shkronja e Fjetër Budit që nuk gjendet në libra të tjerë, Yll Rugova: Gërma "Dh" origjinale, ja kush e gëlbendi

Fatmira Nikolli | 15 Mars, 2023

Oferta për ndërmjetësimin e paqes, Zelensky: Nuk kam marrë asnjë propozim nga President i Kinës

15 Mars, 2023

Lista e PS-së 61 bashkì, konfirmohet shumica e kryetarëshkëshëve aktualë. Ja emrat e rinj

15 Mars, 2023

© 2015 BalkanWeb. Të gjitha të drejtat e rezervuara.